



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr.33/15 Prot.

Tiranë më, 05/08/2025

V E N D I M

Nr. 06 datë 05.08.2025

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Ornela Dyli	Kryesues
Suela Bulku	Relator
Arben Sefaj	Anëtar

në datën 05.08.2025, në orën 09:30, në ambientet e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Nikë Preng Nikollaj, me funksion aktual Specialist, në Sektorin e Hetimit në Mbulim, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; ish Shef Komisariati, në Komisaratin e Policisë Shkodër, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj. Suela Bulku; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni përgjegjës për kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
2. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Z. Nikë Preng Nikollaj, ka dorëzuar *deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, për funksionin Shef Komisariati, në Komisaratin e Policisë Shkodër, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, sipas përcaktimeve të neneve 32, pika 2, 36 pika 1, dhe 44 pika 1, të Ligjit nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
3. Bazuar në nenin 6 të Ligjit nr.12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar, Z. Nikë Nikollaj ka qenë subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit që mbante në datën e hedhjes së shortit, si Shef Komisariati, në Komisaratin e Policisë Shkodër, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.
4. Subjekti i vlerësimit, Z. Nikë Nikollaj, iu nënshtrua procedurës së shortimit, në shortin e zhvilluar në datën 13.02.2025, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07, datë 17.01.2023 *“Për Procedurat e Hedhjes së Shortit”*. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga Znj. Ornella Dyli (Kryesues), Znj. Suela Bulku (Relatore) dhe Z. Arben Sefaj (Anëtar).
5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë. 28. 02. 2023, *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, vendosi me Vendimin nr. ***, datë 06.03.2025, fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Nikë Nikollaj, si dhe të caktojë Kryesues të Trupës Vlerësuese Znj. Ornella Dyli.
7. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 07.03.2025, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar duke i bërë të njohur përbërjen e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, *“Deklaratën për Konfliktin e Interesit”* me nr. *** prot. datë 21.03.2025, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes, në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, nenit 4, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 07.03.2025 , pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
 - nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 07.03.2025, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 07.03.2025, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. *** prot., datë 14.07.2025, ka informuar Trupën e Vlerësimit në lidhje me Urdhërin nr. ***, datë 09.07.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për shkarkimin nga detyra, transferimin dhe emërimin në një detyrë tjetër”*, të Z. Nikë Nikollaj, për shkak të performancës së ulët.
11. Në vijim, Relatori i çështjes, njoftoi institucionet përkatëse për ndërprerje të procesit të hetimit administrativ për subjektin e vlerësimit, Z. Nikë Preng Nikollaj dhe kthim të formularëve të deklarimit dhe dokumentacionit/korrespondencës së nevojshme

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

12. Në zbatim të Ligjit nr. 12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe*

Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, sipas nenit 3, pika 18 e tij, “subjekt vlerësimi” janë punonjësit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6, të këtij ligji.

13. Trupa e Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, administroi dokumentacionet, shkresën nr. ***, datë 14.07.2025, “Njoftim për punonjësin e policisë të emëruar në detyra të tjera”, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe Urdhërin nr. ***, datë 09.07.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “*Për shkarkimin nga detyra, transferimin dhe emërimin në një detyrë tjetër*”, të Z. Nikë Nikollaj, për shkak të performancës së ulët.
14. Nga verifikimi i akteve të administruara, Trupa e Vlerësimit konstatoi se, subjekti i vlerësimit Z. Nikë Nikollaj, është emëruar në detyrën Specialist, në Sektorin e Hetimit në Mbulim, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
15. Sa më sipër Z. Nikë Nikollaj:
 - ***Nuk është subjekt i vlerësimit kalimtar, për shkak të pozicionit të tij të punës jashtë fushës së ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të vlerësimit kalimtar), pozicion që nuk përcaktohet në pikën 1, të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.***
16. Në këto kushte, Trupa e Vlerësimit deklaroi të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak se interesi, qëllimi dhe objekti për të cilin ka nisur procedura janë bërë ligjërisht të pamundur, duke konstatuar se ndodhet në kushtet e zbatimit të nenit 95, të Kodit të Procedurës Administrative.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mbështetur në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit Z. Nikë Preng Nikollaj, me funksion Specialist, në Sektorin e Hetimit në Mbulim, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pa një vendim përfundimtar.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Z. Nikë Preng Nikollaj si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së Vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 05.08.2025, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Ornela DYLI
Kryesues

Suela BULKU
Relator

Arben SEFAJ
Anëtar